

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Ekonomiksi zhvillimit njerëzor
Niveli:	MASTER
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti 1, semestri 1
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	<i>Caktohet nga dekanati në fillim të vitit</i>
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr.Luljeta Elezaj
Detajet kontaktuese:	Fakulteti Ekonomik, UP, Kati 6, Kabineti 78 email: luljeta.elezaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs ka për qëllim që studentëve tu ofrojë një kornizë teorike dhe modele aplikative në bazë të të cilave mund të analizohen forcat/faktorët që përcaktojnë zhvillimet në kapitalin njerëzor. Kapitali njerëzor konsiston në aftësitë dhe shkathtësitë e personave që mund të përdoren në mënyrë produktive në procesin e punës. Në këtë kurs përdoret teoria e ekonomiksit për të analizuar sjelljet e individëve në lidhje me investimin në arsim dhe trajnim dhe përgjithësisht në përmirësimin e shkathtësive dhe aftësive të tyre, normën e kthimit nga investimi në arsim, efektet makroekonomike dhe mikroekonomike të arsimit etj. Po ashtu analizohen edhe politikat që ndikojnë në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Kursi do të ofrojë një analizë kritike të debateve aktuale rreth rolit makroekonomik dhe mikroekonomik të kapitalit njerëzor.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim që: 1. Studentëve tu ofroj një vështrim kritik mbi procesin e krijimit të kapitalit njerëzor në kushtet e ekonomisë së hapur, 2. Të ofrojnë analizë kritike lidhur me efektin mikroekonomik dhe makroekonomik të kapitalit njerëzor në kuadër të ekonomisë kombëtare, 3. Të ofrojnë vështrim kritik mbi politikat e krijimit të kapitalit njerëzor në vend.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në

	gjendje që: 1. Të jenë në gjendje të konceptojnë dhe të ofrojnë analizë kritike të ekonomiksit të kapitalin njerëzor, si në aspektin makroekonomik ashtu edhe mikroekonomik, 2. Të formojnë opinionin kritik në lidhje me efektin e politikave për zhvillim të kapitalit njerëzor.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	12	24
Ushtrime			0
Testet	2	2	4
Zhvillimi i punimit seminarik	4	3	12
Punë e pavarur e studentit (në bibliotekë, shtëpi)			107
Testi Final	3	1	3
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
Gjatë këtij kursi përdoren teoria ekonomike që ofrohet në kuadër të këtij kursi dhe njohuritë e fituara nga analiza mikroekonomike dhe makroekonomike, statistika dhe ekonometria për të analizuar temat që diskutohen në kuadër të këtij kursi. Në kuadër të këtij kursi, studentët kalojnë 24 orë mësimore në kontakt me mësimdhënësin në ligjërata dhe seminare/diskutime (12 javë x 2 orë). Orët e tjera të ngarkesës mësimore në kuadër të këtij kursi studentët duhet t'i kalojnë në studime të pavarura, përgatitjen e seminareve, eseve/punimeve dhe provimin përfundimtar. Mësimi organizohet ashtu që tri javë mbahen ligjërata sipas orarit të paraparë, ndërsa çdo të katërtën javë organizohen seminare (diskutime) rreth një teme të caktuar për të cilën studentët njoftohen paraprakisht. Studentët janë të obliguar që temën e seminarit ta përgatisin paraprakisht për ta diskutuar në orën e seminareve. Studentët inkurajohen që të përgatisin ‘studime rasti’ për tema të caktuara që diskutohen në kuadër të këtij			

	kursi. Këto studime rasti dhe pjesëmarrja aktive në seminare/diskutime kontribuojnë në vlerësimin përfundimtar nga ky kurs. Studentët mund të marrin detyra për të bërë përmbledhjen e ndonjë artikulli/punimi, problemi apo shkrimi që lidhet më çështjet që trajtohen në këtë kurs. Studentët gjithashtu pritët të përgatisin një punim seminarik në lidhje me një temë të zgjedhur paraprakisht. Ky seminar duhet të prezantohet.
Metodat e vlerësimit:	Në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë të punës së studentëve gjatë gjithë semestrit, nota përfundimtare në këtë kurs do të jetë rezultat i: (i) aktivitetit të treguar gjatë ligjëratave dhe seminareve 20% (ii) një punimi me shkrim mbi një temë të caktuar 40% (iii) dhe provimit përfundimtar 40% (i) Aktiviteti në ligjërata dhe posaçërisht në seminare nënkupton përgatitjen e pyetjeve për seminare që diskutohen çdo të katërtën javë. Studentët i marrin pyetjet për seminare një javë përpara dhe pasi të ligjërohen temat përkatëse që diskutohen në seminar. (ii) Punimi me shkrim duhet të përmbajë maksimum 1,500 fjalë dhe duhet të punohet mbi një temë në kuadër të këtij kursi. Pyetjet që diskutohen në seminare mund të jenë tema të mundshme për përgatitjen e punimit me shkrim. Për të marrë notë kaluese punimi duhet të bazohet në teorinë e diskutuar në këtë kurs dhe të ofrojë një qasje kritike të temës që trajton. Në javët e para të kursit studentët do marrin një shembull të një punimi për ta përdorur si mostër se si duhet përgatitur punimi, si duhet të jetë formati i punimi, mënyra e citimit të literaturës, prezantimit të tabelave dhe grafikoneve etj. Punimi duhet të dorëzohet më së largu në javën e fundit të ligjëratave. (iii) Në provimin përfundimtar (sipas afatit të paraparë nga Fakulteti) studentët përgjigjen me shkrim në 2 nga 4 pyetjet e parashtruara. Përgjigjet duhet të jenë të qarta dhe të ofrojnë vështrim kritik të temës që

	trajtojnë. Provimi përfundimtar zgjatë 60 minuta. Gjatë vlerësimit të punimit si dhe të provimin përfundimtar do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: - interpretimi i temës, - thellësia e të kuptuarit të temës, - shfrytëzimi i literaturës, - evaluimi dhe sinteza e evidencës, - analizat kritike dhe - logjika e ndërtimit të argumentit.
Literatura	
Literatura bazë:	1. de la Fuente, A. and Ciccone, A. (2002): Human capital and growth in a global and knowledge-based economy; <i>DG for Employment and Social Affairs</i>, Report for the European Commission, Brussels 2. Belfield, C. (2000): <i>Economic principles of education: Theory and evidence</i>; Edward Elgar, Cheltenham 3. Mincer, J. (1974): <i>Schooling, experience, and earnings</i>; Colombia Press, New York 4. Becker, G. (1975): <i>Human capital: A theoretical and empirical analysis with special reference to education</i>; National Bureau of Economic Research, 2nd edition, New York 5. UNDP (2005): <i>Human development report 2005: International cooperation at a crossroads: Aid, trade and security in an unequal world</i>; Hoechstetter Printing Co., New York 6. UNDP (2006) Raporti i kapitalit njerëzor për Kosovë 7. George Borjas (2002): <i>Labor Economics</i>, 2nd Ed., McGraw-Hill, 2002, 8. Avdullah Hoti (2007): Education, labour market and emigration: Evidence from Kosova, Staffordshire University, Stoke-on-Trent, PhD thesis 9. Instituti Riinvest (2004): Arsimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, Prishtinë
Literatura shtesë:	1. Acemoglu, D. and Angrist, J. (2000): How large are human capital externalities? Evidence from compulsory schooling laws; <i>Massachusetts Institute of Technology</i> 2. Adnett, N. and Davis, P. (2002): Markets for

	schooling: An economic analysis; <i>Routledge research in education</i>, London and New York 3. Ammermueller, A., Heijke, H., Woessman, L. (2003): Schooling quality in Eastern Europe: Educational production during transition; <i>IZA</i>, Discussion paper, 746 4. Ashenfelter, O., Hamon, C., Oosterbeek, H. (1999): A review of estimates of the schooling/earnings relationship, with test of publication bias; <i>Labour Economics</i>, 6: 453-470 5. Barrow, M. (1998): Education after communism – the experience of Central and Eastern European Countries; in <i>Education for All? Regional Monitoring Report No.5, 1998</i>. UNICEF International Child Development Centre 6. Ben Porath, Yoram (1967). "The Production of Human Capital and the Life-Cycle of Earnings." <i>Journal of Political Economy</i>. 75: 352-365. 7. Bills, M. and Klenow, P. (2000): Does schooling cause growth; <i>American Economic Review</i>; 90(5): 1160-83 8. De la Fuente, A. and Ciccone, A. (2002): Human Capital in a Global and Knowledge-based Economy; <i>European Commission</i>, Report for DG Employment and Social Affairs, Brussels 9. Mincer, J. (1997): The production of human capital and the life cycle of earning: Variations on a theme; <i>Journal of Labor Economics</i>, 15(1): S27-S47 10. Mincer, Jacob. (1974) Schooling, Experience and Earnings. NBER. 11. Moretti, E. (1998): Social returns to evidence and human capital externalities: Evidence from cities; <i>University of Berkeley</i> 12. OECD (2002): Education at a Glance: OECD Indicators 2002; <i>OECD</i>, Paris 13. Psacharopoulos, G. and Patrinos, H. (2002): Returns to investment in education: A further update; <i>World Bank Policy Research</i>, Working paper, 2881 14. Sianesi, B. and Van Reenen, J. (2003): The return to education: Macroeconomics; <i>Journal of Economic</i>
--	---

	Surveys, 17(2): 157-200
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në ekonomiksin e kapitalit njerëzor
<i>Java e dytë:</i>	Makroekonomiksi i kapitalit njerëzor dhe efekti në rritjen ekonomike
<i>Java e tretë:</i>	Kapitali social dhe rritja ekonomike
<i>Java e katërt:</i>	Diskutime/seminare
<i>Java e pestë:</i>	Mikroekonomiksi i kapitalit njerëzor dhe diferenca në paga
<i>Java e gjashtë:</i>	Ekonomiksi i arsimit: Teoria dhe metodologjia
<i>Java e shtatë:</i>	Ekonomiksi i arsimit: Evidencë mbi normën e kthimit nga kapitali njerëzor
<i>Java e tetë:</i>	Diskutime/seminare
<i>Java e nëntë:</i>	Politikat e krijimit të kapitalit njerëzor
<i>Java e dhjetë:</i>	Kapitali njerëzor dhe politikat e arsimit në vendet në tranzicion
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kapitali njerëzor dhe politikat e arsimit në Kosovë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Diskutime/seminare
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja në ligjërata dhe seminare është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe seminareve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve gjatë kohës zyrtare së konsultimeve si dhe përmes emailit. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që u është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen si përgatitje për seminar.	